


Fund vere – Fillim vjeshte në ekspozitë artistësh

Artistët Barbara Gashi dhe Skender Strica sjellin verën dhe vjeshtën me veprat e tyre prej arti. Është ekspozita e këtyre dy artistëve e hapur në Sooss afër Badenit (nga data 4 shtator deri më 20 shtator) të këtij viti e cila mahni artdashës të shumtë. Ekspozita është realizuar me ide dhe koncept të Barbara Gashit, piktoresh akademike.

Ajete ZOGAJ

Artdashësit vjenezë tani e një kohë të gjatë shijojnë vepra arti të artistëve të mirënjohur Barbara e Destan Gashi. Puna e tyre artistike, prezantimi i suksesshëm jo vetëm në Vjenë, por edhe në vende të ndryshme të botës, na bënë të ndihemi kërenar me punën e tyre. Maestro Destan Gashi dhe bashkëshortja e tij piktorja akademike Barbara Gashi me artin e latuar në gurë (Destani) dhe me harmoninë e ngjyrave në pikturë (Barbara), sforcojnë edhe njëherë bindjen se kombi ynë i ka dhuruar Evropës dhe botës artistë të mëdhenj. Kësaj radhe, piktorja akademike, Barbara Gashi për artdashësit vjenezë, shpalos veprat artistike në pikturë me një artist shkodoran, Skender Strica. Në informatën e dërguar në email, piktorja akademike Barbara Gashi, dëshiron ta informoj lexuesin shqiptar për këtë ekspozitë dhe vlerësimet e artdashësve atje. Sipas informacionit të Barbarës Gashit, hapja e ekspozitës është bërë nga Roland Bimo, ambasador i Republikës së Shqipërisë në Austri dhe artistja Dorothea Soevogjarto. Ajo sjellë një fragment nga fjala e hapjes së ambasadorit: "Ekspozita në Sooss është pa dyshim një kontribut me vlerë në afrimin e mëtejshëm të Shqipërisë dhe Austrisë duke folur gjuhën e përbashkët të



pikturës.

Njerëzit janë të ndryshëm. Jo vetëm nga një shtet në tjetrin apo nga një etni në tjetrën por edhe brenda komuniteteve të tyre. Ajo që i sjell gjithnjë afër është ndjenja e të bukurës. Një veprë arti, siç janë pikturat e znj. Barbra Gashi dhe Z. Skënder Strica të ekspozuara, komunikojnë lirshëm midis njerëzve pavarësisht e cilido qoftë sfondi i tyre kulturor. Është interesant të vihet në dukje një fakt; është pikërisht kultura ajo që i dalton kombet por është arti ai që i sjell natyrshëm afër njeri tjetrit. Dhe në këtë rast vlerësimi për këtë ekspozitë, përveç pasurimit artistik që marrin vizitorët, qëndron në faktin se ndihmon komunikimin dhe sjell me afër shoqëritë tona. Kaq e vërtetë është kjo, sa vetëm në momentin e fundit me shkoi mendja se znj. Gashi është lindur në Austri dhe Z. Strica në Shqipëri. Aktiviteti i pasur i piktorit Skender Strica në disa vende të Evropës, si dhe ky mbartim me vete dëshminë se arti shqiptar është në pararojë edhe të përpjekjeve që bëhen për integrimin e vendit tonë në Evropë.

Ndërkaq, për artisten Dorothea Soevogjarto, jo vetëm tablote janë shumë të këndshme, por edhe fakti që këtë herë Barbara Gashi, gruaja e skulptorit Destan Gashi, përfaqësohet në Heurigen Galerie me pikturat e saj. Ajo ndër të tjera foli edhe për jetën e çiftit artist Barbara dhe Destan Gashi, të cilët kanë studiuar së bashku në vitet 080 në Bruksel në Akademinë e Arteve. Skulpturat e kosovarit Destan Gashi dhe sidomos figurat dy metër e lartë prej mermeri "Drejtueshëm" (Balance) në mes të galerisë, u janë të njohura prej vitesh shëtitoreve dhe vizitorëve në qytetën Sooss. Në pikturat e Barbara Gashit

mbizotërojnë motivet nga stina e verës: të notuarit në liqen, zhytja në ujë, peshqit në det, piktura këto të cilat brusha e artistes Gashi i stolisë me një humor të këndshëm ashtu siç është edhe stina e verës.

Nëpër mjet këtyre pikturave, adhuruesit e pikturës kanë mundësi që edhe kur është acar ta shijojnë ujën e kaltër si kristal dhe ngjyrat e qiellit, hedhjen në ujë për t'u freskuar. Ndërkaq, Tablloja e Barbara Gashit "Irisi nën ylber" të bën ta parandiesh vjeshtën. Pikturat e bukura të artistes Barbara Gashi kësaj radhe ekspozohen së bashku me pikturat e artistit shkodoran Skender Strica, për të sjellë tek vjenezët bukurinë e Alpeve shqiptare, peizazhe të mrekulueshme nga Shqipëria, duke na magjepsur me ngjyra e kolorit. Pyje me një ngjyrë të kuqe të portokalltë shtrihen pranë lëndinave në ngjyrë të gjelbër të thellë dhe fushave me ngjyrë okër, kurse malet e mbuluara me mjegull shfaqen në forma mistike, ashtu si gojëdhënat dhe legjendat e Shqipërisë.

Biografi: Barbara Gashi

Barbara Gashi 1963 e lindur në Vjenë të Austrisë 1981. Me artistin kosovar Destan Gashi u njohën në Venecia të Italisë, njohje kjo e cila më vonë do të rezultojë me martesën e tyre. Prej atje, Barbara së bashku me artistin e madh shqiptar Destan Gashi (bashkëshorti i saj) do të shkojë në Bruksel, ku Destani do të studiojë skulpturën (1981) kurse Barbara pikturën. Më pas do të vazhdojë studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në Bruksel të Belgjikës te profesori André Ruelle. Në vitin 1987 çifti Gashi diplomojnë dhe kthehen në Vjenë ku punojnë dhe krijojnë si artistë të pavarur (1989 – 2003). Barbara punon

si cicerone dhe udhëheq në palatin Hofburg të Vjenës në dy muze (apartamente mbretërore dhe në dhomën e argjendit). Prej vitit 2003 vepron si piktoresh e pavarur dhe punon edhe në disa vende interesante si në një galeri në Vjenë, në një librarë të artit dhe prej vitit 2008 të një kompani të Vjenës me traditë shumë të vjetra J&L Lobmeyr. Njëkohësisht Barbara vazhdon shkollimin e mëtejshëm për menaxhmentin e kulturës, bën organizimin e ekspozitave në Austri dhe jashtë atdheut, punon edhe si kuratore. Disa ekspozita prej viteve të fundit: 2005 Schloss Concordia, Vjenë 2005 BAËAG Vjenë (ekspozitë personale) 2006 Hotel Mariver në Jesolo Itali (ekspozitë personale) 2007 EIFI Vjenë (ekspozitë personale) 2008 Galeri në Kulturhof, Breitenbrunn, AUSTRI (ekspozitë personale) 2009 Art-Galerie në Schloss Gabelhofen, AUSTRI 2010 Paulus Apotheke, Vjenë (ekspozitë personale) 2011 Galeri Altesse në Nendeln, Liechtenstein 2012 Johann Gassner Haus, Vjenë 2013 Kultursaal Himberg, AUSTRI 2014 Bibliotheka Kombetare Pjetër Bogdani, Prishtinë, Kosova 2014 Theater Migjeni, Shkodër, Shqipëri. Shumë vepra gjenden nëpër koleksione private në Austri, Itali dhe Gjermani, BAËAGU nga Vjena duke i blerë disa punime.

Biografia e Skender Stricës

Piktori Skender Strica lindi më 29 Mars 1955 në qytetin e Shkodrës, Shqipëri. Mësimet e para të pikturës i mori nga piktorët e njohur Jakup Keraj dhe Ferdinand Paci. Në vitin 1970 nisi studimet për pikturë në Tiranë nën kujdesin e piktorëve të njohur S.Kaceli dhe N.Bakalli. Pas përfundimit të

studimeve caktohet të punojë mësues vizatimi në qytetin piktoresk B. Curri, ku qëndroi për dy vite, duke hapur ekspozitën e parë personale në vitin 1975. Duke parë absurditetin tematik të pikturës në regjimin e atëhershëm komunist, vendos t'i përkushtohet vetëm peisazhit, gjë të cilën vazhdoi ta bëjë edhe tani. Merr pjesë në të gjitha ekspozitat lokale dhe kombëtare, duke u shquar për koloritin impresionist dhe sinqeritetin shprehës. Pas viteve 90, me ardhjen e demokracisë në Shqipëri, i përkushtohet pikturës duke punuar si piktor në profesion të lirë. Nga viti 1999 deri në 2003, emigron në Maltë dhe punon një vit mësues vizatimi në "Euro-Institute Of Music & Art", si dhe tre vite dizajner pranë "Artec Kontrakt Design". Ekspozitën e parë në Maltë e hap së bashku me piktorin e mirënjohur maltez, Fransis Galla në vitin 2000, ndërsa ekspozitën personale e hap në vitin 2001 në Zebug (Maltë), ku koleksionisti John Bonici i blen 16 punime. Pas kthimit nga Malta, hap galerinë e parë private në Shkodër "Rozafa Art & Gallery", me punimet e veta dhe shumë autorëve më në zë të Shqipërisë. Ekspozitën e parë personale në qytetin e lindjes e hap në galerinë e tij private në vitin 2007, duke u paraqitur me 24 punime nga Liqeni i Shkodrës. Ekspozitën e dytë personale "Nostalgi Dimri", e hap në vitin 2009 në hollin e Bashkisë Shkodër, me të veçantën e vet ku të gjithë peizazhet janë me dëborë. Ndërsa ekspozitën e tretë vetjake, "Vjeshtë Në Alpe", në vitin 2011 e hap në hollin e "Hotel Rozafa". Në ekspozitat e fundit piktori Skender Strica, shquhet për gjetjet e reja jo vetëm tematike, por për originalitetin shprehës, koloritin impresionist dhe profesionalizmin në realizim, duke u bërë kështu piktori më i kërkuar i viteve të fundit. Duke qenë prezent në shumë aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, ai ka marrë shumë vlerësime nga njerëz të artit dhe koleksionistë. Qindra punime të piktorit ndodhen në institucionet kryesore, ambientet luksoze në vend, si hotele, restorante, rezidenca etj., dhe në koleksionet private. Mbi 50 peizazhet e piktorit ndodhen në koleksionet private në Mal të Zi, Kroaci, Maltë, Turqi, Amerikë, Kanada etj.